

ANALIZA E PENSIONIMIT
NË UNIVERSITETIN E
PRISHTINËS:
PROFESORËT E
RREGULLT QË NUK
JUSTIFIKOJNË TITUJT E
TYRE AKADEMIK

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8,
10000 Prishtina, Kosova

Autorë:

Venera Çoçaj
Adea Kondirolli

Prishtinë, korrik 2018

Rron Gjinovci

“REVOLUCIONI APO EVOLUCION?” – KJO NUK ËSHTË ÇËSHTJA

Kjo analizë vjen si detajzim i mëtotjeshëm nga të dhënat e mbledhura nga raporti i dhjetorit 2017 me titull “Integriteti Akademik i Profesorëve në Universitetin e Prishtinës” i publikuar nga ORCA. Në këtë raport gjetëm se 72% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt e tyre akademik parë nga aspekti i punimeve shkencore që duhen për titujt respektiv. Ajo që ne ngritëm si shqetësim të veçantë ishte rasti i 122 profesorëve të rregullt, të cilët mbajnë titullin më të lartë akademik dhe si rrjedhojë kontratë me kohë të pacaktuar. Pra, fjala është për profesorët të cilët nuk kanë më asnjë detyrim ndaj Universitetit në kuptimin e publikimit të punimeve apo avancimit të tyre akademik e profesional, ndërkohë që vendi i tyre i punës merr statusin e pacenueshmërisë.

Ditën e publikimit të raportit pati edhe diskutime dhe një nga çështjet që u shtrua nga një pjesëmarrës lidhur me çështjen e 122 profesorëve të rregullt të cilët nuk i justifikojnë titujt e tyre akademik, ishte nëse duhej “revolucionari apo evolucionari” si qasje në çështjen e mosjustifikimit të titujve akademikë. Propozimi ishte që të mos merreshin masa, por që të pritej për një kohë të shkurtër ashtu që profesorët që nuk e justifikojnë titullin akademik të dalin dalëngadalë në pension duke presupozuar se mosha e tyre e shtyer, pra pensionimi eventual, punon në favor të rritjes së cilësisë në këtë aspekt. Kjo qe qasja “evolutive” e propozuar përkundër rekomandimeve tona “revolucionare” për verifikim të titujve nga një autoritet qendror.

Duke qenë se në akademi thuhet se përparimet janë të ngadalshme dhe duke dyshuar për një moment në mundësinë që ne jemi naivë, iu përveshëm punës për të parë çdo të thoshte evolucionin në rastin e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Nga analiza na doli se:

Profesori i fundit i rregullt që nuk e justifikon titullin e tij do të pensionohet në vitin 2036. Kjo do të thotë se fëmijët që aktualisht janë 3 vjeçar do të mund të mentorohen në temat e tyre të diplomës në nivelin bachelor te ky profesor; fëmijët aktualisht 5 vjeçar do të mund të mentorohen në nivelin master nga po ky profesor; ndërsa dikush nga fëmijët aktualisht 10 vjeçar mund ta ketë fatin të mentorohet në doktoraturën e tij/saj nga profesori në fjalë.

Kjo analizë jep të dhëna progresive, pra sipas viteve në vazhdim, të pensionimit të profesorëve që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademik në përgjithësi nëpër të gjitha njësitë akademike, me theks të veçantë të profesorëve të rregullt për arsyet e cekura më lart.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Universiteti i Prishtinës deklaroi në faqen e vet të internetit se ka 42,006 studentë dhe 900 anëtarë të stafit akademik. Nga një llogaritje e përafërt del se raporti staf akademik-studentë në Universitetin e Prishtinës është 1:47. Aarhus University në Danimarkë në vitin 2016 e ka pasur raportin staf akademik-studentë 1:4, ndërsaq Universiteti i Vjenës në vitin 2016/2017 e ka pasur raportin staf akademik-studentë 1:14.

Në vitin 2017 Universiteti i Prishtinës në faqen e vet ka pasur 481 CV të profesorëve me tituj akademik (Profesor Asistent, Profesor i Asociuar dhe Profesor i Rregullt) që nënkupton numrin total të stafit akademik me tituj. Prej 481 del se 346 (72%) nuk i justifikojnë titujt akademik.¹ Nga 346 që nuk i justifikojnë titujt akademik, 122 janë profesorë të rregullt.

Në 2018, 21 profesorë që nuk i justifikojnë titujt akademikë janë pensionuar. Prej tyre 16 janë profesorë të rregullt.

33 profesorë nga të gjithë titujt akademikë që nuk i justifikojnë titujt akademikë dhe janë në moshë të pensionimit figurojnë ende si staf i rregullt i Universitetit.

Profesori i fundit i rregullt që nuk e justifikon titullin e tij do të pensionohet në vitin 2036. Kjo do të thotë se fëmijët që aktualisht janë 3 vjeç do të mund të mentorohen në temat e tyre të diplomës në nivelin bachelor të ky profesor; fëmijët aktualisht 5 vjeç do të mund të mentorohen në nivelin master nga po ky profesor; ndërsaq dikush nga fëmijët aktualisht 10 vjeç mund ta ketë fatin të mentorohet në doktoraturën e tij/saj nga profesori në fjalë.

Universiteti i Prishtinës duhet të krijojë mekanizma dhe politika serioze për të adresuar problemin e mosjustifikimit të titujve.

Universiteti i Prishtinës duhet ta ndalojë praktikën e vazhdimet të punësimit të profesorëve të pensionuar, sidomos në rastet kur këta profesorë nuk i justifikojnë titujt.

Universiteti i Prishtinës duhet ta rrisë numrin e stafit akademik për kokë studentit gjithnjë në përputhje me standardet e cilësisë së stafit akademik të parapara me dispozitat në fuqi.

Një vlerësim dhe verifikim tërësor i titujve akademikë në institucione të arsimit të lartë paraqitet i domosdoshëm. Duhet të krijohet një mekanizëm ose institucion me pjesëmarrje ndërkombëtare, për të verifikuar dhe unifikuar titujt akademikë.

1. "Integriteti Akademik i Profesorëve në Universitetin e Prishtinës," ORCA, dhjetor 2017, link: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/Integriteti-akademik-i-profesoreve-ne-Universitetin-e-Prishtines.pdf>

REZULTATET

“Integriteti Akademik i Profesorëve në Universitetin e Prishtinës”² i botuar nga ORCA në dhjetor 2017, zbuloi që 346 nga 481 profesorë (ose 72% e tyre) nuk i justifikojnë titujt akademikë, bazuar në metodologjinë e shtjelluar më poshtë.

140 nga 481 profesorë janë profesorë të rregullt (kanë kontratë të përhershme me universitetin); 122 nga 140 profesorët e rregullt nuk justifikojnë titujt akademikë.

Qasja analitike e këtij raporti është të kuptohet faktori i moshës në raport me procesin e pensionimit të profesorëve që nuk justifikojnë titujt akademikë. Moshë e pensionimit në Kosovë është 65 vjeç, e rregulluar me ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.³ Ligji nuk kufizon të drejtën për të punuar pas pensionimit, dhe në rastin e Universitetit të Prishtinës shumë punëtorë, specifikisht profesorë me tituj akademikë, vazhdojnë të ligjërojnë edhe pas pensionimit.

Kjo analizë sjell numrin e saktë të profesorëve aktualë që janë 65 vjeç ose më shumë në vitin 2018.

Profesorët e rregullt që nuk i justifikojnë titujt akademikë

Nga 346 profesorët që nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë, 122 janë profesorë të rregullt (në total 140 profesorë të rregullt ishin të punësuar deri në dhjetor 2017, që

nënkupton që vetëm 18 profesorë të rregullt justifikojnë këtë titull), që është titulli akademik më i lartë në Universitetin e Prishtinës.

Nga 122 profesorët e rregullt që nuk i justifikojnë titujt akademikë, 36 prej tyre ose 29% priten të pensionohen në vitin 2018 sepse janë 65 vjeç ose më shumë. 75 ose 61% e profesorëve të rregullt që nuk justifikojnë titujt akademikë priten të pensionohen përgjatë 18 viteve të ardhshme; që do të thotë që profesori më i ri i rregullt që nuk justifikon titullin e tij akademik do të pensionohet në vitin 2036. Për 11 raste nuk është arritur të verifikohet gjendja sepse profesorët nuk kanë publikuar CV-të e tyre ose nuk kanë deklaruar ditëlindjen. Por për 3 raste, është arritur të konfirmohet përmes burimeve të tjera si uebfaqja e fakultetit⁴ ose raportime mediale⁵ se një prej tyre është pensionuar dhe nuk është më i punësuar, ndërkaq dy të tjerë janë 65 vjeç, por vazhdojnë të ligjërojnë siç paraqitet në uebfaqen e fakultetit.

Për më shumë, nga 36 profesorët që priten të pensionohen në 2018, vetëm 16 ose 44% të tyre janë pensionuar, ndërkohë që 20 ose 56% të tjerë vazhdojnë të ligjërojnë. Në total 16 (13%) nga 122 profesorë të rregullt që nuk justifikojnë titujt akademikë janë pensionuar, që do të thotë që 106 ose 87% e profesorëve të rregullt që nuk justifikojnë titujt akademikë janë ende pjesë e stafit akademik të Universitetit të Prishtinës.

2. Po aty.

3. Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të financuara nga shteti, Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9517>

4. Personeli akademik i Fakultetit Juridik, Linku: <https://juridiku.uni-pr.edu/Personeli/Personeli-akademik.aspx>

5. Avancohet Profesori i UP-së 10 Ditë Para Pensionimi, 31.05.2017, linku: <https://kallxo.com/avancohet-profesori-se-10-dite-para-pensionimit/>

Periudhat e pensionimit	Profesorët e rregullt që nuk i justifikojnë titujt akademik	
2018	36	29%
2019-2036	75	61%
Nuk dihet periudha e saktë	11	10%

Tabela 1. Profesorët e rregullt që nuk justifikojnë titujt akademikë dhe ritmi i pritur i pensionimeve

Profesorët e rregullt që nuk justifikojnë titujt e tyre akademik 2018-2036		
Të pensionuar	16	13%
Të papensionuar	106	87%
Total	122	100%

Tabela 2. Profesorët e rregullt që nuk justifikojnë titujt akademikë; të pensionuar ose jo të pensionuar.

Periudhat e detajuara të pensionimit të profesorëve të rregullt		
Viti i pensionimit	Mosha aktuale	Numri i profesorëve të rregullt që nuk justifikojnë titujt akademikë
2018	69	2
	68	5
	67	6
	66	11
	65	12
2019	64	11
2020	63	6
2021	62	10
2022	61	10
2023	60	8
2024	59	6
2025	58	7
2026	57	2
2027	56	6
2028	55	3
2029	54	2
2030	53	0
2031	52	1
2032	51	0
2033	50	2
2034	49	0
2035	48	0
2036	47	1
N/A	N/A	11
2018-2036		122

Tabela 3. Afati kohor i detajuar i pensionimeve të profesorëve të rregullt që nuk justifikojnë titujt

Mosha e pensionimit të profesorëve të të gjithë titujve (Profesor Asistent, profesor i Asocuar, Profesor i Rregullt) që nuk i justifikojnë titujt akademikë - 2018

Në 2018, 54 profesorë që nuk justifikojnë titujt e tyre akademik janë 65 vjeç ose më shumë; 36 ose 67% nga ta janë profesorë të rregullt, 11 ose 20% janë profesorë të asocuar, dhe shtatë ose 13% janë profesorë asistent.

Nga 54, 21 ose 39% të profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë, janë të pensionuar, ndërkohë që 33 ose 61% vazhdojnë të ligjërojnë.

Nga 21 profesorët që janë pensionuar, 16 janë profesorë të rregullt, tre janë profesorë të asocuar dhe dy janë profesorë asistent.

Nga 33 (61%) të profesorëve që vazhdojnë të ligjërojnë, 20 janë profesorë të rregullt, tetë janë profesorë të asocuar dhe pesë janë profesorë asistentë.

Profesorët e pensionuar në 2018	21	39%
Profesorët mbi 65 vjeç që vazhdojnë të ligjërojnë	33	61%
Numri total i profesorëve mbi 65 vjeç në 2018	54	100%

Tabela 4. Numri total i profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë që janë 65 vjeç ose më shumë në 2018 – të pensionuar, ose që vazhdojnë të ligjërojnë.

Profesorët që nuk justifikojnë titujt akademikë (që priten të pensionohen në 2018)			Të pensionuar në 2018		Vazhdojnë punën	
Titulli akademik	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Profesor i rregullt	36	67%	16	44%	20	56%
Profesor i asocuar	11	20%	3	27%	8	73%
Profesor asistent	7	13%	2	29%	5	71%
Totali	54	100%	21	39%	33	61%

Tabela 5. Përshkrim i detajuar i profesorëve që nuk i justifikojnë titujt dhe që janë 65 vjeç ose më shumë, sipas titujve akademikë dhe nëse janë pensionuar apo jo në 2018.

Përmbledhje e fakulteteve

Në 2018, numri i profesorëve të punësuar u zvogëluar për 2%, ku 33 profesorë nuk janë më të listuar si staf akademik në uebfaqen e Universitetit të Prishtinës. 23 profesorë të rinj janë shtuar si staf akademik në UP. Në total, janë 471 profesorë të punësuar në Universitetin e Prishtinës, ndërkohë që vitin e kaluar numri ishte 481.

Nga 33 profesorët që nuk janë më të listuar si staf akademik, 21 prej tyre janë 65 vjeç apo më shumë, sipas ditëlindjeve të tyre në CV-të zyrtare të publikuara në uebfaqet e fakulteteve. Ndërkohë që për 12 profesorët e tjerë jo të listuar, arsyeja nuk është pensionimi ose ishte e pamundur të verifikohej mosha e tyre në CV-të zyrtare.

	FAKULTETET	2017	Stafi i ri akademik	Stafi që nuk figuron në uebfaqe për arsye që nuk dihen (2018)	Stafi që mungon për shkak të pensionimit 2018	2018
1	Fakulteti i Edukimit	36	2			38
2	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	14				14
3	Fakulteti Juridik	40	2			42
4	Fakulteti Filozofik	32	2	1	1	32
5	Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore	62	8	3	2	65
6	Fakulteti Ekonomik	45				45
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	23	2	1	3	21
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	29	2		2	29
9	Fakulteti i Mjekësisë	95	2	1	7	89
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	33				33
11	Fakulteti Filologjik	50		6	6	38
12	Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës	22	3			25
	Numri total i stafit akademik	481	23	12	21	471

Tabela 6. Numri total i stafit akademik në 2017 dhe 2018, stafi i ri dhe stafi i pensionuar.

METODOLOGJIA

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË CV-VE

Baza ligjore

1. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës⁶
2. Statuti i Universitetit të Prishtinës, neni 175⁷
3. Rekomandimi 1/344 i Senatit të UP-së për publikimet shkencore relevante për zgjedhje të stafit akademik është marrë parasysh si orientim vetëm në rastet kur nuk ka qenë në kundërshtim me Statutin, pasi ORCA ka publikuar analizën të saj që argumenton kundërthëniet e rekomandimit me Statutin e UP-së.⁸

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statuti i UP-së për zgjedhje në njërin nga titujt akademik: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt. Ky kriter siguron aktivitetin e vazhdueshëm shkencor, i cili është kyç në përvetësimin e metodave dhe rezultateve bashkëkohore, mbi të cilat garantohej mësimdhënia dhe kontributi i qëndrueshëm shkencor.

6. Ligji për Arsimin e Lartë, Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>

7. Statuti i Universitetit të Prishtinës

8. Rekomandimi 1/344 i senatit të Universitetit të Prishtinës miratuar me 22.06.2017

Objekti i shqyrtimit

CV-të e 122 profesorëve të rregullt me marrëdhënie të rregullt pune në 12 fakultetet e Universitetit të Prishtinës që nuk plotësojnë kriteret për të qenë profesor i rregullt sipas Ligjit për Arsim të Lartë dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve. Rrjedhimisht, profesorët e Fakultetit të Arteve nuk janë pjesë e raportit të ORCA-s.

Periudha e mbledhjes së materialit për hulumtim

Të gjitha CV-të e shqyrtuara janë marrë në uebfaqen zyrtare të UP-së uni-pr.edu, gjatë periudhës së hulumtimit prej datës 01.06.2017 deri më 31.08.2017. Për arsye të saktësisë së të dhënave, këto CV i janë nënshtruar rishqyrtimit gjatë intervalit kohor 01.09.2017 deri më 30.09.2017. Të gjitha ndryshimet që janë evidentuar gjatë rishqyrtimit, janë aplikuar përshtatshëmrisht në bazën e të dhënave të hulumtimit mbi të cilin është ndërtuar ky raport.

Hulumtimi i pensionimit është bërë gjatë dhjetor 2017, dhe është rishqyrtuar në prill 2018. Të gjitha ndryshimet që janë evidentuar gjatë rishqyrtimit, janë aplikuar përshtatshëmrisht në bazën e të dhënave të hulumtimit mbi të cilin është ndërtuar ky raport.

Metodologjia e shqyrtimit të justifikimit të titujve

Pavarësisht kohës së marrjes së titullit akademik, ORCA ka shqyrtuar justifikimin e titujve vetëm krahas kritereve të përcaktuara me aktet aktuale juridike. Ndonëse është e qartë që disa nga profesorët i kanë marrë titujt akademikë në kohën kur ka pasur dispozita tjera në fuqi, ORCA ka tentuar ta paraqesë gjendjen aktuale të punimeve të publikuara në revista shkencore që i përmbushin kriteret dhe parimet e përcaktuara në këtë metodologji.

Për pozitën profesor të rregullt, personi duhet të ketë të botuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante sipas Statutit të UP-së si autor i parë apo korrespondent.⁹

Cilësimi i punimit shkencor

Duke u bazuar në aktet juridike të cekura më lartë, ORCA nuk i ka cilësuar si publikime relevante punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raporte, projekte apo libra të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare.

Punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë botuar, nuk vlejné sipas Statutit të UP-së dhe si të tilla ORCA nuk i ka cilësuar si publikime shkencore relevante për titujt përkatës.

Publikimet në revista shkencore rajonale, sipas Rekomandimit 1/344 të Senatit për të qenë relevante duhet të jenë të indek-

suara në të paktën njërin nga databazat indeksuese akademike Scopus apo Web of Science. Rrjedhimisht ORCA nuk i ka cilësuar si relevante publikimet në revista rajonale jashtë këtyre databazave.¹⁰

Punimet të cilat janë të publikuara vetëm si abstrakte dhe që as me anë të abonimit në revistën përkatëse nuk mund të shihen të plotë, ORCA nuk i ka cilësuar si publikime relevante për kriterin e përmendur.

Dokumentet referente të hulumtimit

Punimet e publikuara në revistat që janë pjesë e listave që i cilësojnë ato si të dyshimta, nuk janë marrë për bazë si punime shkencore relevante. Metodologjia e përdorur nga ORCA për identifikimin e revistave të dyshimta mbështetet në:

1. Parimet e Transparencës të përpiluara nga disa prej organizatave më prestigjioze të botimeve shkencore: Committee on Publication Ethics (COPE), Directory of Open Access Journals (DOAJ), Open Access Scholarly Publishers Association (OASPA), World Association of Medical Editors (WAME);¹¹

2. Listat e Jeffrey Beall të përditësuara së fundmi në janar të vitit 2017.¹²

Përrjashtimisht ato publikime në revista të dyshimta, janë marrë si publikime relevante shkencore vetëm në rastet kur revista në kohën e publikimit të punimit ka qenë e indeksuar në databazat indeksuese akademike Web of Science apo Scopus.¹³

9. Neni 175, pika 1.2.1 i statutit të UP-së

10. Pika 3 e Rekomandimit 1/344

11. Parkimet e Transparencës dhe Praktikant më të Mira në Botim Shkencor <https://publicationethics.org/files/Principles%20of%20Transparency%20and%20Best%20Practice%20in%20Scholarly%20Publishing.pdf>

12. Criteria for Determining Predatory Open-Access Publishers by Jeffrey Beall <https://bealllist.ëeebly.com/uploads/3/0/9/5/30958339/criteria-2015.pdf>

13. Pika 5 e Rekomandimit 1/344

PARIMET E TRANSPARENCËS NGA COPE, DOAJ, OASPA DHE WAME:

1. Procesi i recensionit: E gjithë përmbajtja e revistës, përveç ndonjë materiali editorial që është i shënuar në mënyrë të qartë si e tillë, do t'i nënshtrohet shqyrtimit të recensentëve. Shqyrtimi nga recensentët definohet si marrja e këshillave për dorëshkrime individuale nga ekspertë të fushës, e të cilët nuk janë pjesë e stafit të redaksisë së revistës. Ky proces si dhe çdo politikë që lidhet me procedurat e revistës për shqyrtimin nga kolegët, do të përshkruhen në mënyrë të qartë në faqen e internetit të revistës.
2. Trupi qeverisës: Revistat duhet të kenë borde redaktuese ose organe të tjera drejtuese, anëtarët e të cilave janë ekspertë të njohur në lëmitë e përfshira në fushëveprimin e revistës. Emrat e plotë dhe përkatësitë e redaktorëve të revistës duhet të jepen në faqen e internetit (WEB faqen) të revistës.
3. Ekipi redaktues dhe informatat e kontaktit: Revista duhet t'i sigurojë dhe t'i publikojë emrat e plotë dhe përkatësitë e redaktorëve të revistës si dhe informacionin e kontaktit për zyrën e redaksisë në faqen e saj të internetit.
4. Tarifat e autorit: Të gjitha tarifatat ose pagesat që janë të nevojshme për përpunimin e dorëshkrimeve dhe/ose për materialin botues të tyre në revistën përkatëse, duhet të shprehen qartë në një vend që është i lehtë për t'u gjetur nga autorët e mundshëm para dorëzimit të dorëshkrimeve të tyre për shqyrtim.
5. E drejta e autorit: E drejta e autorit dhe informacionet e licensimit duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë në faqen e internetit të revistës, dhe kushtet e licensimit duhet të tregohen në të gjitha artikujt e botuar si HTML dhe si PDF.
6. Identifikimi dhe marrja me rastet e mundshme të keqpërdorimeve hulumtuese: Redaktorët dhe botuesit duhet të marrin masa të arsyeshme për t'i identifikuar dhe për t'i parandaluar botimet e punimeve ku ka ndodhur keqpërdorim hulumtues, duke përfshirë ndër të tjera dhe: plagjiaturë, manipulim me citim, dhe të dhënat të falsifikuara apo të trilluara. Një revistë ose edhe redaktorët e saj në asnjë rast nuk duhet të nxisin keqpërdorime të tilla ose me vetëdije të lejojnë që sjellje të tilla të ndodhin. Në rast se botuesi i revistës apo redaktorët janë vënë në dijeni të ndonjë akuze për keqpërdorim hulumtues në lidhje me një artikull të botuar në revistën e tyre - botuesi apo redaktori do të ndjekin udhëzimet e COPE-it (ose ekuivalente) për shqyrtim ndaj akuzave.
7. Pronësia dhe menaxhimi: Informatat në lidhje me pronësinë dhe/ose menaxhimin e revistës do të tregohet qartë në faqen e internetit të revistës. Botuesi nuk do të përdorë emra organizate që do të mund t'i çorientojnë autorët dhe redaktorët potencial në lidhje me natyrën e pronarit të revistës.
8. Faqja e internetit: Faqja e internetit e një reviste, duke përfshirë edhe tekstin që ajo përmban, duhet të tregojë se është dhënë kujdes i veçantë për të siguruar standarde të larta etike dhe profesionale.

9. Emri i revistës: Emri i revistës duhet të jetë unik dhe të mos jetë i tillë që është lehtësisht i ngatërrueshëm me një revistë tjetër, gjë që mund të arrijë deri te çorientimi i autorëve dhe lexuesve potencialë në lidhje me origjinën e revistës ose bashkëpunimin me revista të tjera.
10. Konfliktet e interesit: Një revistë duhet të ketë politika të qarta për trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të redaktorëve, autorëve dhe shqyrtuesve. Këto politika duhen të shprehen qartë.
11. Qasja: Mënyrat në të cilën revista dhe artikujt individual janë të qasshëm për lexuesit duhet të deklarohen. Po ashtu mënyrat lidhur me pagesën përmes abonimit apo pagesës për çdo pamje, duhet të deklarohen qartë.
12. Burimet e të ardhurave: Modelet e biznesit ose burimet e të ardhurave (p.sh. tarifatat e autorit, abonimet, reklamat, ribotimet, mbështetjet institucionale, dhe mbështetjet organizative) duhet të shprehen qartë dhe dukshëm në faqen e internetit të revistës.
13. Reklama: Revista duhet të deklarojë politikën e saj reklamuese (nëse kanë reklama), duke përfshirë edhe çfarë lloje të reklamave do të konsiderohen, kush merr vendime në lidhje me pranimin e reklamave dhe nëse ato janë të lidhura me përmbajtjen apo me sjelljen e lexuesit (vetëm online), ose shfaqen në mënyrë të rastësishme.
14. Periudha botuese: Periodiciteti me të cilën publikohet revista duhet të shprehet qartë.
15. Arkivimi: Plani i revistës për ruajtjen e kopjes elektronike rezervë dhe ruajtjen e qasjes së përmbajtjes të revistës (për shembull, qasja në artikujt kryesorë nëpërmjet CLOCKSS ose PubMedCentral) në rast se një revistë nuk publikohet më, duhet të tregohet në mënyrë të qartë.
16. Marketing i drejtpërdrejtë: Çdo formë aktivitetesh të marketingut, përfshirë kriteret kushtëzuese për dorëshkrimet që kryhen për revistën, duhet të jenë të përshtatshme, të adresuara qartë dhe që nuk ndërhyjnë apo imponohen [ndaj përdoruesit pa dijeninë/pëlqimin e tij].

Tregues të tjerë që përcaktojnë revista të dyshimta nga metodologjia e përdorur për listimin e revistave të tilla nga Jeffrey Beall

Revista konsiderohet e dyshimtë:

1. Nëse anëtarët e ekipit redaktorial të revistës nuk kanë angazhim relevant shkencor në fushat përkatëse dhe nëse anëtarët e redaksisë së revistës publikojnë vazhdimisht në atë revistë.
2. Nëse kontaktet funksionale të ekipit redaktorial nuk janë të qasshme në faqen e revistës.
3. Nëse revista promovon faktin që është e listuar në platforma indeksimi të dyshimta apo çorientuese si rasti i Index Copernicus etj. Një revistë serioze nuk duhet ta promovojë listimin në platforma indeksimi joserioze.
4. Nëse periodiciteti me të cilën publikohet revista nuk shprehet qartë dhe nuk duhet të jetë subjekt i luhatjeve drastike në kohë.
5. Nëse punimet e botuara në një revistë karakterizohen nga gabime gjuhësore (anglisht) apo gramatikore, dhe paraqitje jo-adekuate të simboleve të përdorura në llogaritje numerike. Çdo revistë serioze duhet të ketë kapacitete të redaktimit gjuhësor/kuptimor.
6. Nëse punimet e botuara në një revistë karakterizohen me deformime estetike ose nuk janë të shkruara në formatin që revista e kërkon. Për shembull, dy punime në të njëjtën revistë janë shkruar në formate të ndryshme ose një punim në disa pjesë është shkruar me një format e në disa faqe të tjera është shkruar me një tjetër.

ORCA nuk paragjykon dijeninë apo qëlimshmërinë e autorëve sa i takon botimeve të tyre në revista të dyshimta, por është mjaftuar të evidentojë situatën mbi faktin e kryer.

Shqyrtimi individual dhe kolektiv nga hulumtuesit

Secilit hulumtues i janë ndarë numër i caktuar i CV-ve në mënyrë rastësore. Secili hulumtues ka shqyrtuar nëse revista ku ka qenë punimi i publikuar shkencor bie ndesh me parimet e lartshkruara në rastet kur ato kanë qenë afirmative. Po ashtu, ka parë nëse revista ku është publikuar punimi i plotëson kriteret dhe parimet e vendosura nga Parimet e Transparencës, dhe nëse kanë plotësuar kriteret e vendosura nga lista e revistave të dyshimta të Beall.

Të dhënat e nxjerra nga shqyrtimi janë vendosur në tabela të standardizuara nga ku ka vazhduar shqyrtimi i mëtejshëm kolektiv.

Pas përfundimit të hulumtimit individual është mbledhur rrethi i parë i kolegjiut të hulumtuesve i cili ka shqyrtuar veç e veç secilën revistë të listuar nga hulumtuesit. Pas shqyrtimit, rezultatet janë dërguar te konsulencia e jashtme për kontroll të dyfishtë apo për këshilla profesionale. Pas përgjigjes nga konsulencia është mbledhur rrethi i dytë i kolegjiut të hulumtuesve i cili ka shqyrtuar përgjigjet e konsulencës dhe me konsensus ka shpallur të mbyllur hulumtimin.

Metodologjia e pensionimit të profesorëve

Bazuar në hulumtimin e CV-ve gjatë 2017 (metodologjia e definuar në pjesën e parë), ne kishim të dhëna se sa profesorë plotësojnë kriteret për të qenë profesorë në Universitetin e Prishtinës.

Këto të dhëna pastaj janë analizuar në bazë të moshës, specifikisht moshës së pensionimit. Ne kemi hulumtuar vitin e pensionimit të 122 profesorëve të rregullt (që kanë kontratë të përhershme në Universitet), që nuk plotësojnë kriteret për të qenë profesorë, për të parë kur do pensionohen.

Ky hulumtim është bazuar në dokumente zyrtare, si CV-të e profesorëve ku kanë deklaruar ditëlindjen e tyre, raportime të medieve, dhe uebfaqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës.

Hulumtimi i pensionimit është bërë gjatë dhjetor 2017, dhe është rishqyrtuar në prill 2018.

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i orrucionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

